



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE



**amshc**

Agjencia për Mbështetjen  
e Shoqërisë Civile

## PROGRAMI ANTI-KORRUPSION

### Treguesi i Lëndës:

Shkurtime ..... faqe 02

#### Kapitulli I

Kuadri i Përgjithshëm Ligjor ..... faqe 03

Politikat dhe Misioni i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ..... faqe 04

Objektivi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ..... faqe 04

#### Kapitulli II

Zhvillimi Historik i Institucionit ..... faqe 05

- Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile ..... faqe 05

Ofrimi i Lehtësive ..... faqe 06

Anëtarësimet e Realizuara ..... faqe 06

#### Kapitulli III

Reformat e Ndërmarrja ..... faqe 07

- Krijimi i Infrastrukturës për Denoncime ..... faqe 07

a. Instalimi i Numrit të Dedikuar Call Center ..... faqe 07

b. Krijimi i Portalit Anti- Korrupsion ..... faqe 07

c. Organizimi i takimeve të Vazhdueshme ..... faqe 08

- Lehtësimi i Procedurave Burokratike ..... faqe 08

a. Analizimi i Procedurave ..... faqe 08

b. Konsolidimi i tyre ..... faqe 08

- Përmirësimi i Kapacitetit Institucional ..... faqe 09

#### Kapitulli IV

Baza Ligjore ..... faqe 09

Plani i Veprimit ..... faqe 10

#### Kapitulli V

Mbështetja Institucionale ..... faqe 11



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

**SHKURTIME :**

AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
ADISA	Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKSHI	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit
AP	Avokati i Popullit
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
DAP	Departamenti i Administratës Publike
KM	Këshilli i Ministrave
MD	Ministria e Drejtësisë
SNKK	Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit
DPS	Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit
BSH	Banka e Shqipërisë
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
IQ	Inspektoriati Qendror



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

## KAPITULLI I

### *Kuadri i Përgjithshëm Ligjor:*

Programi Anti- Korrupsion kornizohet ligjërisht përmes akteve të miratuara nga Qeveria Shqiptare të cilat, në vetvete, sanksionojnë dhe rregullojnë veprimtarinë e Organit Qendror (në rastin konkret- të AMShC- së) sipas parashikimeve të publikuara.

Kjo kornizë ligjore shkon paralel me akte të tjera ligjore të cilat nuk çënojnë në zbatimin e tyre zbatimin e misionit të AMShC- së në thelb.

E thënë konkretisht, ky program, është pikë zbatimi i një programi umbrellë i cili inicon dhe vijon prej Kryekoordinatorit të tij- Ministria e Drejtësisë.

Vendimi Nr. 247 datë 20.03.2015 “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për Periudhën 2015- 2020” i Këshillit të Ministrave, pasqyron qartë gjëndjen në të cilën ndodhet korrupsioni dhe objektivat për realizim të kësaj strategjie të cilat do të ndihmojnë të minimizojnë këtë fenomen në të ardhmen.

Për t’i ardhur në ndihmë kësaj nisme por edhe referuar nevojave të ndryshme të adresuara në këtë prizëm, Qeveria Shqiptare, me Vendimin Nr. 241 datë 20.04.2018 “Për Miratimin e Planit të Veprimit 2018- 2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015- 2020, e të Pasaportës së Indikatorëve, Krijimin, Funkcionimin dhe Detyrat e Komitetit Koordinator për Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015- 2020 dhe Task- Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion”.

Ky vendim i fundit, qartëson edhe më tej planin konkret të Institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Antikorrupsion duke specifikuar konkretisht Objektivat të cilat i gjejmë në sistemin tabelor të mëposhtëm:

	<b>Numër Objektivi</b>	<b>Numër Mase</b>	<b>Indikatorët</b>
Qasja Parandaluese	11 Objektiva	52 Masa	21 Indikatorë
Qasja Ndëshkuese	4 Objektiva	19 Masa	9 Indikatorë
Qasja Ndërgjegjësuese	3 Objektiva	26 Masa	7 Indikatorë

Siç mund të shikohet qartë, në mënyrë të përmbledhur do të kemi: 18 objektiva në total të ndara në qasjet Parandaluese, Ndëshkuese dhe Ndërgjegjësuese. Për të arritur këto objektiva, do të duhet të merren 97 masa të ndara sipas objektivit përkatës dhe fund, do të duhet të zbardhim 37 indikatorët për masat e ndërmarra në funksion të arritjes së objektivave sipas qasjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Ashtu siç edhe parashikohet, AMShC, është angazhuar në arritjen e Objektivit C3 “Inkurajimi i Bashkëpunimit me Shoqërinë Civile”.

Ky objektivi, parashikon për AMShC- në krijimin e një programi antikorrupsion, financimin e projekteve me objektivi specifik- këtë program dhe promovimin e bashkëpunimit me organizata të shoqërisë civile të cilat fokus të krijimit të tyre kanë korrupsionin dhe luftën kundër tij.

Krijimi i programit antikorrupsion është proces vijues i hartimit të vendimit të brendshëm për këtë akt zbatimi i të cilit do të zhvillohet paralelisht me thirrje për financime për projekt- propozime me në qendër luftën kundër korrupsionit, luftën ndaj tij dhe organizimin e fushatave sensibilizuese ndaj këtij fenomeni.

Arsyeja që aktorë të shoqërisë civile në shqipëri, janë përfshirë në Strategjinë kundër Korrupsionit është se ekspertiza e realizuar nga ekspertët, shfaq nivelin e lartë të këtij fenomeni në çdo fushë të rendit shoqëror.

### ***Politikat dhe Misioni i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile:***

AMShC është Institucion publik, qendror dhe buxhetor. I nominuar i tillë për shkak të Ligjit Organik të saj me Nr. 10 093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, AMShC- së i janë përcaktuar funksionet të cilat do të realizohen përmes objektivave dhe misioneve të parashikuara në aktin Ligjor të saj.

### ***Objektivi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile:***

Me anë të nxitjes, përmes asistencës financiare, e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimit të kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut, AMShC, si objektivi specifik të saj përmban:

- Nxitjen e bashkëpunimit me organizata të shoqërisë civile që kanë objekt të punës mbikqyrjen e luftës kundër korrupsionit, kundër trafikimit të qenieve njërezore e trajtimit të viktimave të saj, kundër dhunës në familje e ndaj fëmijëve;
- Nxitjen e qytetarëve në veprimtari, në përfshirje dhe pjesëmarrje në zhvillimin e komunitetit;
- Krijimin dhe konsolidimin e aftësive të shoqërisë civile;
- Zhvillimin e bashkëpunimit ndërsektorial dhe bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile;
- Rritjen e ndikimit publik dhe veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile;
- Zhvillimin e sipërmarrjes shoqërore dhe punësimin në sektorin jofitimprurës;
- Rritjen e ndikimit të shoqërisë civile në proceset e hartimit dhe të miratimit të politikave publike;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

## KAPITULLI II

### *Zhvillimi Historik i Institucionit:*

AMShC- ja si ent qendror buxhetor, ka vijuar punën e saj prej muajit maj 2009 duke nisur me institucionalizimin e saj- proces i cili ja rrallë herë është hasur i vështirë, si për nga ana logjistiko-organizative ashtu edhe nga ana ligjore sa i përket pajisjes së tij me elementet zyrtarë.

Në vijim, janë realizuar takimet prezantuese me organet qendrore dhe lokale duke mundësuar prezantimin e Institucionit, misionit të tij dhe objektivave. Takime janë zhvilluar edhe në kuadër të arritjes së mundësive për krijimin e partneritetit me organe të qeverisjes lokale të kohës.

Kulmi i zhvillimit të këtij Institucioni embrional, ishte organizimi i Thirrjes Nr. 1 për financim me grant të projekteve të shoqërisë civile. Thirrja u organizua në dy faza.

Në fazën e parë, përfaqësuesit e shoqërisë civile, dorëzonin koncept- idenë dhe elementet përmbledhës të projektit (burimet njerëzore, termat e referencës, buxhetin etj).

Me këtë rast, me ndihmën e partnerëve të huaj (ndihma e GIZ), AMShC organizoi një event me temë: Panairi i Koncept Ideve pranë Hotel Rogner Tiranë, ku rreth 50 (pesëdhjetë) subjekte të shoqërisë civile, prezantuan koncept- idetë e tyre pranë publikut dhe aktorëve të shoqërisë civile, me qëllim ofrimin e varianteve të tyre sociale në ofrimin e asistencës përmes zbatimit të projekteve pranë grupeve në nevojë.

### *- Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile:*

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) erdhi si nevojë e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë europian. Ndodhur në këto kushte, u krijua grupi i punës i cili ishte përgjegjës për hartimin e Ligjit për KKShC- në, në përbërje të të cilit ishin përfaqësues të Qeverisë Shqiptare dhe Shoqërisë Civile. Modeli i strukturës së Ligjit u huazua nga modelet më të mira europiane derisa, pas realizimit të konsultave publike dhe elektronike, me propozim të Këshillit të Ministrave, u miratua Ligji Nr. 119/ 2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”.

Ky Ligj garanton bashkëpunimin institucional me organizata të shoqërisë civile në dobi të zgjerimit të demokracisë, konsolidimit të qeverisjes së mirë dhe rritjes së transparencës në vendimmarrjen publike përmes, përfshirjes më të mirë të shoqërisë civile në këtë proces.

Zhvillimi i bashkëpunimit institucional me organizatat e shoqërisë civile për hartimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare dhe udhërrëfyesit të Qeverisë Shqiptare për krijimin e një kuadri mundësues për sektorin e shoqërisë civile është një tjetër element që ky Ligj asiston dhe ofron në funksion të marrëdhënieve ndërsektoriale mes institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile.

Anëtarësia në Këshill, sipas Ligjit, është sanksionuar me 13 (trembëdhjetë) anëtarë- përfaqësues të Institucioneve Shtetërore në nivel të lartë drejtuesi ndërsa, 13 (trembëdhjetë) anëtarë- përfaqësues të Shoqërisë Civile. Anëtari i fundit- jo për nga rëndësia, është përfaqësuesi i Komitetit të Biznesit- Anëtar i Këshillit Ekonomik Kombëtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Përzgjedhja e përfaqësuesve të shoqërisë civile, përcaktohet përmes organizimit të zgjedhjeve elektronike (on- line) të cila organizohen nga AMShC- ja në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit.

***Ofrimi i Lehtësive:***

Opinionin i përgjithshëm në vend, ishte skeptik në fillimet e kësaj nisme, mirëpo AMShC- ja, bazuar në vullnetin e saj të plotë, arriti përmes shumë vështirësive, të finalizojë arritjen e heqjes së burokracive lidhur me ofrimin e lehtësive si në aksesin e vendimmarrjes administrative, ashtu edhe në atë organizative.

Në këtë situatë, ndihmë e posaçme është ofruar edhe në modelet dhe orientimet ligjore në fuqi si për informimin publik ashtu edhe për transparencën e institucionit përmes publikimit të çdo informacioni në faqen zyrtare të AMShC- së kështu,

AMShC- ja, publikon periodikisht në faqen e saj, çdo ndryshim dhe informacion duke pasuruar këtë dritare informimi me të gjitha të dhënat e mundshme dhe të nevojshme.

Institucioni ka një program transparence me të gjitha elementet e tij duke ofruar akses të përgjithshëm për të interesuarit. Mënyra e vendimmarrjes dhe format e saj, janë të publikuara gjithashtu në faqen e internetit duke ofruar hapësirë për lexim dhe përdorim të tyre.

***Anëtarësimet e Realizuara:***

Me zhvillimin institucional të AMShC- së, është mundësuar, përmes punës së palodhur të institucionit, të ofrohen bashkëpunime dhe partneritete me organizma ndërkombëtar të akredituara në territorin e Shqipërisë por edhe me akses implementimi projekti në këtë territor.

Ndër këto anëtarësime, më i rëndësishmi është Subjekti Centro Laici Italiani per le Missioni- CELIM (<https://www.celim.it>) ku AMShC është partner në projektin “Community Action for Conservation of Protected Areas- C.A.P.A.”.

Vlerë të shtuar anëtarësimin të AMShC- së në organizmat ndërkombëtarë, i jep edhe akreditimin në European Voluntary Service (EVS) ([https://europa.eu/youth/EU/voluntary-activities/european-voluntary-service\\_en](https://europa.eu/youth/EU/voluntary-activities/european-voluntary-service_en)) e programit Erasmus+ si dhe Joint Technical Committee- JTC (<https://jtc1info.org/>),



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

### KAPITULLI III

#### *Reformat e Ndërmarrë:*

##### *Krijimi i Infrastrukturës për Denoncime:*

AMShC- ja, si Institucion për zbatimin e masave të parashikuara, në emër dhe për llogari të saj, ashtu siç edhe janë përmendur më herët, parashikon veprime të cilat, paralelisht me ushtrimin e funksioneve të saj, do të ndikojnë në plotësimin dhe pasqyrimin e plotësimin të objektit të krijimit dhe angazhimit të ndërmarrë.

Thënë sa më sipër, AMShC, ka ndërmarrë një sërë hapash dhe veprimesh lidhur me infrastrukturën e nevojshme për denoncimin e aktit të korrupsionit duke ofruar shumë lehtësira në funksion të denoncuesve në përlllogaritje të moshave të ndryshme eventuale të cilat denjojnë të shprehin haptazi një akt korruptiv qoftë edhe në perceptim.

Kjo infrastrukturë përbëhet nga tre angazhime të cilat shpalosen si më poshtë:

##### *a. Instalimi i Numrit të Dedikuar Call Center:*

Ndër angazhimet e para të ndërmarrë nga AMShC është instalimi i numrit të dedikuar të telefonit lëvizës enkas për denoncimin e rasteve korruptive në fushën e veprimtarisë së shoqërisë civile.

Pavarësisht problemeve burokratike shtetërore në funksion të instalimit të këtij numri dhe mënyrës së përzgjedhjes së tij, sot, AMShC zotëron numër të dedikuar për denoncimin e rasteve korruptive.

Numri i dedikuar është disponibël në çdo orë të ditës dhe të natës me qëllim që denoncuesit të kenë akses të plotë në denoncimin e rasteve edhe në kohë reale.

Numri i është caktuar për përdorim personit përgjegjës të kontaktit të Institucionit për Strategjinë Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit ku si detyrë kryesore është përpilimi i një draft-raporti lidhur me numrin e denoncimeve në çdo ditë të fundit të javës pranë titullarit të Institucionit.

##### *b. Krijimi i Portalit Anti- Korrupsion:*

Në vazhden e angazhimeve Institucionale, AMShC krijoi edhe portalin anti- korrupsion në nivel elektronik duke hartuar mënyrën dhe formën e denoncimit të akteve të korrupsionit në veprimtarinë e shoqërisë civile.

Kështu, është hartuar adresa elektronike duke referuar publikimin e saj në mediat sociale të krijuara për AMShC- në.

Me instalimin final të këtij portali, AMShC, pretendon të jetë ndër Institucionet e para të cilat, me seriozitet, ofrojnë aksesin e publikut në vendimmarrje dhe politikbërje institucionale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

**c. Organizimi i takimeve të Vazhdueshme:**

Përgjatë vitit 2019 por edhe më tej, bazuar në parashikimin e planit të veprimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, AMShC, ka implementuar takime informuese me aktorë të shoqërisë civile në rrethe të ndryshme të vendit.

Qëllimi i këtyre takimeve informuese, është jo vetëm informimi i publikut me masat e parashikuara nga dhe në emër të AMShC- së por, edhe informimi i tyre lidhur me Strategjinë në tërësi, masat e parashikuara nga Institucionet, raportet e zbardhura deri në momentin e zhvillimit të takimeve si dhe, nevojën për rishikueshmërinë e kësaj strategjie, bazuar në nevojat reale dhe të marra ballë për ballë me shoqërinë civile si pala e impaktuar nga kjo strategji për këtë prioritet.

***Lehtësimi i Procedurave Burokratike:***

**a. Analizimi i Procedurave:**

Bazuar në eksperiencën e deritanishme (rreth tetë vjeçare) si dhe në propozimet verbale të kryera nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, AMShC u angazhua në thellimin e kërkesave të parashtruara me rastin e aplikimeve por jo vetëm, edhe në raste të tjera burokratike të cilat, ndodhin rëndom pranë Institucionit.

Ndodhur në këto kushte, AMShC është treguar përherë e afërt me problematikat e hasura nga shoqëria civile ndaj, u angazhua në ofrimin e lehtësirave administrative në funksion të një shoqërie civile sa më të plotë juridikisht ndaj, u propozua që një sërë ndryshimesh të ndodhin si pasojë e kësaj nisme duke filluar me setin e dokumentave ligjorë për dorëzim në kuadër të mbështetjes financiare dhe duke vijuar me mënyrën e trajtimit të kërkesave dhe ankesave të përfaqësuesve të shoqërisë civile.

**b. Konsolidimi i tyre:**

Në vijim të hyrjes së mësipërme, AMShC, u tregua e gatshme për përthithjen e praktikave më të mira të implementuara nga donatorë të huaj të akredituar në Shqipëri ndaj edhe vendosi, pas miratimit përmes propozimit të AMShC- së, nga Bordi Mbikqyrës, të reduktojë numrin e dokumentave për financim me grant.

Dokumentat e reduktuara janë të së njëjtës kategori siç mund të përmendim, dorëzimin e Vendimit të Regjistrimit dhe Statutit në formën fotokopje të tyre duke qenë se rolin e tyre, e luan Ekstrakti Gjyqësor i cili dorëzohet në formën origjinale.

Ndryshime të kësaj natyre, kanë ndodhur edhe për dokumenta të tjera duke mundësuar, ofrimin e lehtësirave financiare për organizatat e shoqërisë civile.

Konsolidimi i kësaj praktike, solli përgëzimin e aktorëve të shoqërisë civile drejt AMShC- së si iniciatore e kësaj nisme.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

*Përmirësimi i Kapacitetit Institucional:*

AMShC- ja, është objekt i vazhdueshëm i pjesëmarrjes në trajnime dhe konferenca të ndryshme që realizohen nga subjektet shtetërore dhe ndërkombëtare.

Qëllimi i pjesëmarrjes është përthithja e ideve inovative me fokus përmirësimin e ambientit të shoqërisë civile në Shqipëri.

Në eksperiencat e saj, AMShC, përherë është treguar e gatshme të përvetësojë ato më të mirat duke zbatuar sugjerimet dhe komentet e trajnuesve në procedurat dhe hapat e saj sipas parashikimeve.

#### KAPITULLI IV

*Baza Ligjore:*

*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*, në nenin 244 të tij “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” sanksionon: “*Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet*” ndërsa në nenin 259 “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, ky Kod sanksionon: “*Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet*”.

*Vendimi Nr. 247 i Këshillit të Ministrave*, datë 20.3.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015- 2020” në pjesën hyrëse të tij shprehet: “*Korrupsioni është pengesa kryesore në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm politik, ekonomik dhe shoqëror të shteteve. Në vitin 2013, Shqipëria shënoi sërish për të tretin vit radhazi vendin e fundit, nga vendet e rajonit në renditjen e indeksit global të perceptimit të korrupsionit duke marrë kështu damkën si vendi më i korruptuar në Evropë. Ulje - ngritjet e perceptimit publik në 10 vitet e fundit, objektivisht, përkojnë me reformat e kryera ose të munguara të qeverisjes. Për këtë arsye, qeveria e konsideron perceptimin e publikut mbi korrupsionin jo vetëm si tregues për gjendjen reale të tij (të korrupsionit), por edhe si masë për suksesin apo dështimin e politikave dhe programeve të qeverisë në luftën kundër korrupsionit. Përkundrajt këtij sfondi faktesh dhe kësaj vetëdije politike e shoqërore, me objektivin përfundimtar të modernizimit të qeverisjes në vend, qeveria angazhohet për luftë pa kompromis dhe zero tolerancë kundër korrupsionit duke i dhënë kësaj politike publike përparësinë që meriton*”.

*Vendimi Nr. 241 i Këshillit të Ministrave*, datë 20.04.2018 “Për miratimin e planit të veprimit 2018- 2020, në zbatim të strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit, 2015- 2020 e të pasaportës së indikatorëve, krijimin, funksionimin dhe detyrat e Komitetit Koordinator për zbatimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit, 2015- 2020 dhe Task- Forcës



## AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

ndërinstitucionale antikorrupsion”, në Objektivin C3 “Inkurajimi i Bashkëpunimit me Shoqërinë Civile”, sanksionon plan masash për t’u realizuar nga Institucioni përgjegjës (AMShC) ku përmendet:

1. Hartimi i vendimit të brendshëm për krijimin e një Programi Antikorrupsion në AMShC, thirrje për propozime specifike që kanë në qendër korrupsionin;
2. Nisja e thirrjes për propozime posaçërisht për të synuar korrupsionin, si pjesë e programit antikorrupsion, (krijimi i infrastrukturës së duhur me një numër telefoni dhe një email të disponueshëm për raportimin e provave;
3. Zhvillimin e seancave trajnuese dhe sensibilizuese me aktorë të shoqërisë civile;

Plani i ri i Veprimit 2018- 2020 në funksion të Strategjisë Antikorrupsion, përbëhet në total nga 18 objektiva, ku **11** prej tyre bëjnë pjesë në *qasjen parandaluese* (e cila ka për qëllim çrrënjosjen e korrupsionit së pari nga radhët e administratës publike dhe të të gjithë segmenteve shtetërore dhe kryesisht nga institucionet që ofrojnë shërbime publike për qytetarët), **4** në *qasjen ndëshkuese* (ka për qëllim që insitucionet ligjzbatuese dhe veçanërisht ato të pavarura, të cilat kanë një rol thelbësor në këtë proces, duhet të monitorojnë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës, duke siguruar kështu transparencën dhe integritetin e organeve shtetërore) dhe **3** në *qasjen ndërgjegjësuere* (ka për qëllim që publiku të marrë pjesë në luftën kundër korrupsionit duke e denoncuar atë dhe duke qenë aktiv në iniciativa që synojnë parandalimin e fenomeneve korruptive).

**Plani i Veprimit:**

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, është organ zbatues i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. Përgjegjësia e zbatimit të planit të punës, i referohet objektivit C.3 “Inkurajimi i Bashkëpunimit me Shoqërinë Civile” që i përket Qasjes Ndërgjegjësuere.

Plani i veprimit, është objekt i ndryshimeve varësisht nevojave dhe situatave qeveritare me qëllim, ofrimin e një plani masash gjithëpërfshirës dhe sa më pranë organizatave joqeveritare.

Për vitet 2019- 2020, AMShC- ja, ka parashikuar një sërë masash realizimi i të cilave do të ndihmojë në arritjen e objektivave të synuar.

Më poshtë do të sjellim në formë tabelore masat/ aktivitetet e parashikuara në funksion të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit:

Nr.	Masa/ Aktiviteti	Vlera	Afati
1	Mbështetje Financiare për Projekte që ndërgjegjësimin e publikut dhe ofrojnë asistencë në denoncimin e rasteve korruptive	20.200.000 mln <u>+20.200.000</u> 40.400.000	2019 2020
2	Realizimi i Seancave Informuese me aktorë të shoqërisë civile lidhur me prezantimin e masave dhe arritjeve	200.000 <u>+200.000</u> =400.000	2019 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

## KAPITULLI V

### *Mbështetja Institucionale:*

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, paralel me mbështetjen financiare për zbatimin e projekteve nga subjekte të shoqërisë civile, ka mision të saj edhe mbështetjen institucionale kundrejt individëve apo subjekteve të cilët e kërkojnë një mbështetje të tillë.

Nocioni i mbështetjes institucionale, përkon me ofrimin e aksesit në informacion dhe vendimmarrje të institucioneve. Kjo mbështetje institucionale realizohet përmes financimit me grant për mbështetje institucionale ku përfshihen investimet strategjike që u jepen organizatave, zhvillimi i të cilave është i rëndësishëm:

- Për rritjen e qëndrueshmërisë së shoqërisë civile;
- Për kontributin në përmirësimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri etj.

Mbështetja institucionale, është konceptuar si proces i hapur dhe konkurues dhe mund të marrë formën e:

**Granteve afatgjate**- për aktivitete specifike, qëllimi i të cilave është përmirësimi i situatës së përgjithshme të të gjitha organizmave jofitimprurës në shqipëri;

**Grante për organizata**, aktiviteti i të cilave është i rëndësishëm për ekzistencën e një shoqërie civile të pavarur duke përfshirë grupet e të drejtave të njeriut, organizatave vëzhguese etj.

2019

Shënim: Ky Program, është objekt i ndryshimeve të nevojshme varësisht nevojave.